



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punës dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 83

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303

Prishtinë, më 22 nëntor 2013, në orën 10:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca dhe Liburn Aliu.

Munguan: Flora Brovina dhe Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: -Shpresa Haxhijaj - koordinatorë e Komisionit, Xheneta Sopjani - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës
Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës

Fikrim Damka- Tha se komisionet e përhershme kanë vlerësuar se projektligji për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe me Ligjet e zbatueshme, nuk kanë implikime buxhetore dhe nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe mund të procedohen për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Kosovës.

Sa i përket amendamentin 7, të propozuar nga Sasha Milosavljeviq në emer të grupit parlamentar SLS, është përkrahur nga Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Të deklarohej edhe ne, si komision, edhe një herë për këtë amendament.

Amendamenti 7 GP-SLS pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, me përkrahjen e Komisionit të Komuniteteve.

Në nenin 3, paragrafi 1.20 riformulohet si vijon:

“Grupet e cenueshme” janë ato grupe që kërkojnë punë ose janë të papunë si: nëna me shumë fëmijë, nënat vetushqyese, personat në moshën mbi 50 vjeç, të kthyerit në Kosovë dhe personat e zhvendosur interno të papunë një kohë të gjatë, të kthyerit dhe personat e zhvendosur interno dhe personat që marrin ndihmë sociale.

Time Kadrijaj- Tha se duke i parë levizjet e popullsisë që po bëhen prej një qyteti në tjetrin, nëse ne e përkrahim këtë amendament mund të shkaktojmë parregullësi në Qendrat e Agjencisë së punësimit.

Sasha Gjokiq- Tha se nuk jam kontaktuar nga anëtarët e GP SLS, për ta përkrahur këtë amendament, andaj me shpjegimet që u dhanë nuk do ta përkrahi këtë amendament.

Nazane Breca- Tha se pajtohem me mospërkrahjen e këtij amendamenti.

Pas diskutimit Komisioni nuk përkrahi amendamentin e propozuar nga GP SLS, ndërsa njëzetit përkrahi amendamentet e propozuara në Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës , dhe procedoj raportin përfundimtar për miratim në seancë.

4. Të ndryshme

Fikrim Damka – Tha se për pikën të ndryshme kemi kërkesën e deputetit Sasha Gjokiq, dhe ja dha fjalën.

Sasha Gjokiq-Tha se nuk jam i kënaqur me mënyrën e punësimit që po bëhet në komunat e reja, të themeluara sipas pakos së Ahtisarit. Në këto komuna Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Punës dhe Mirëqenies Sociale po bëjnë punësimin në baza politike, madje duke larguar nga puna punëtorët aktual.

Edhe Ministria e Shëndetësisë ka pranuar në punë drejtorët e qendrave mjekësore mbi baza politike.

Propozoj që për mbledhjen e radhës të ftohen ministrat e ministrive përkatëse dhe të diskutohet mënyra e punësimit të stafit në komunat e reja.

Liburn Aliu- Tha se jam dakord që t'a ftojme ministrinë e Ministrisë së Punës dhe ta pyesim në përgjithësi se si është bërë punësimi i stafit.

Pas diskutimeve u konstatua se për javën e parë të dhjetorit të ftohen në mbledhje të Komisionit, ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Punës dhe Mirqenies Sociale.

Fikrim Damka- Tha se për pikën të ndryshme u ngrit edhe çështja e Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.

Sa i përket këtij projektligji akoma nuk kemi marrë ndonjë shkresë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, por sipas rregullores së Kuvendit, ne kemi të drejtë ta procedojmë Projektligjin për miratim në seancë pa mendimin e tyre, pasi ka kaluar koha e paraparë për shqyrtim.

Liburn Aliu- Tha se në mbledhjen e ardhshme ne duhet të votojmë që ta procedojmë Projektligjin në seancë dhe deri atëherë, duhet t'i njoftojmë të dyja komisionet që Projektligji do të procedohet në seancë me, ose pa deklarinimin e tyre.

Salihe Mustafa- Tha se edhe pse me rregullore ne kemi të drejtë ta procedojmë Projektligjin, mendoj që nuk duhet të ngutemi. Administrata le t'ua dërgoj komisioneve njoftimin që ne do ta procedojmë Projektligjin pasi ka kaluar koha e paraparë me Rregullore të Kuvendit.

Fikrim Damka- Tha se menjëherë t'u dërgojmë një shkresë Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të kërkojmë nga ta që të procedojnë raportin për këtë Projektligj dhe për Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti. Nëse deri në javën e parë të dhjetorit nuk marrim raportin nga këto dy komisione, ne do të procedojmë për seancë Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.

Fikrim Damak – Tha se çështje tjetër që e kemi ta diskutojmë është kërkesa e kompanisë “Prima pharm”. Hap diskutimin.

Liburn Aliu- Tha se do të ishte mirë që t'i ftojme edhe përfaqësuesit e “Prima Pharm” dhe problemet e tyre t'i diskutojmë me ministrin, sepse konsideroj që nuk mjafton vetëm ta lexojmë kërkesen.

Time Kadrijaj- Tha se në këtë shkresë shihen disa shkelje, që sipas meje duhet të pyetet AKPPM-ja si ka ardhur deri te këto. Ne jemi dëshmitarë të shumë aferave në sektorin farmaceutike.

Kurse sa i përket shëndetësisë në përgjithësi, kemi keqmenaxhim të buxhetit dhe shkelje të ligjit nga vetë zyrtarët kompetent.

Sasha Gjokiq- Tha se nuk e kam pasur shkresën në gjuhen serbe, por mendoj se kemi të drejtë, si Komision, të ftojme aktorët dhe të diskutojmë çështjen e licencave. Ne duhet ta mbështesim respektimin e ligjit.

Salihe Mustafa- Tha se për shqyrtimin e kësaj çështje kemi nevojë për më shumë kohë dhe konsultim me ministrin. Këtë shkresë duhet ta trajtojmë si dukuri me Ministrin e Shëndetësisë dhe assesi të lëshohemi në detaje e ta trajtojmë si rast të veçantë, sepse është kompetenc e gjykatës.

Liburn Aliu- Tha se një dukuri negative si kjo është përgjegjësi edhe e jona si Komision. Jam dakord që nuk është kompetenc e Komisionit ta luajë rolin e gjykatës dhe të ndajë drejtësi, por ne duhet t'a trajtojmë bashkë me ministrin këtë çështje.

Nazane Breca- Tha se ne nuk jemi organ gjyqësor, andaj nuk kemi nevoj ta ftojme askënd. Ne duhet t'a hulumtojmë këtë dukuri dhe ta ngrehim në diskutim me ministrin.

Sasha Gjokiq- Tha se desha të ngritën edhe disa çështje që kanë të bëjnë me keqpërdorimet e Ministrisë së Shëndetësisë, që po ndodhin në spitale dhe në shtëpitë e shëndetit. Ka keqpërdorime në punësim mbi baza politike, por edhe keqpërdorime të barnave dhe shumë çështje të tjera, të cilat inspeksioni nuk po i trajton.

Bahri Thaçi- Tha se sa i përket shkresës që e kemi marrë nga "Prima Pharm" nuk kemi nevojë që t'a ftojme ministrinë, sepse edhe ministri i ka përafersisht po këto informata të cilat i kemi edhe ne. Mendoj që është më së miri ta ftojme U.D së kryeshefit ekzekutiv të AKPPM-së dhe t'i marrim përgjigjet për rastin.

Fikrim Damka- Tha se jemi dakorduar që edhe për këtë temë ta ftojme ministrin e Shëndetësisë.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka